



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- 400-689 13

Me datë 28.10.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenin 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, e konform vendimit me numër, 01-Nr-16-887, të datës 23.02.2011, të miratuar në Kuvendin e Komunës në Suharekë, e në mbështetje të nenit 44, lidhur me nenin 48, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016", Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

AKTVENDIM

- I. Lejohen mjete financiare në vlerë prej **3.000,00€** në emër të z. Arsim Kabashi, pasi që është shpallur nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, fitues i çmimit "Ukë Bytyçi" për Udhëheqje të mirë, mjetet lëshohen nga subvencionet e zyrës Kryetarit.
- II. Për zbatimin e këtij aktvendimi kujdeset Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet.
- III. Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës në Suharekë me vendimin numër, 01-Nr-16-887, të datës 23.02.2011, ka themeluar çmimin "Ukë Bytyçi" për udhëheqje të mirë, më të cilin vendim është caktuar se aji i cili e fiton këtë çmim, vlera e çmimit është 3.000,00€, me vendimin e datës 27.09.2022 me numër të protokollit, 01-Nr-016-62354, të miratuar në Kuvendin e Komunës në Suharekës, z. Arsim Kabashi, është shpallur fitues i çmimit "Ukë Bytyçi" për Udhëheqje të mirë, andaj duke ju referuar vendimeve të cekura më lartë, Kryetari i Komunës vendosi që mjete financiare në vlerë prej **3.000,00€** të lëshohen në emër të z. Arsim Kabashi-t pasi që është fitues i çmimit të lartë cekur, mjetet lëshohen nga subvencionet e zyrës së Kryetarit të Komunës, andaj edhe u vendos si në nenin 1 të këtij aktvendimi

Me sa u tha më lartë vendos si në nenin 1 të këtij aktvendimi.

Të njoftohen;
DEFB-ja
Pala
Evidenca

